

### Procedurë për zbatimin e komponentes nxitëse

Duke qenë se:

- Në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 106, Datë, 02.07.2020<sup>1</sup>, specifikohet si vijon:

Aneksi 12.4 “Përcaktimi i çmimeve të disbalancave”, pika 3.5.:

“Komponentja nxitëse”:

a) Vlera fillestare: €0/MWh

b) Rregullimet e komponentes nxitëse

3.5.b.1. OST do të rregullojë komponentën nxitëse në bazë të kritereve objektive sipas një procedure të përcaktuar dhe të publikuar nga OST në faqen zyrtare.

3.5.b.2. Vlera aktuale e komponentes nxitëse do të publikohet në faqen zyrtare të OST.

3.5.b.3. ERE ka të drejtën në çdo kohë të shqyrtojë procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse dhe nëse është e nevojshme i kërkon OST ta dergojë këtë procedurë për t’u miratuar në ERE dhe ta përfshijë si pjesë e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit”.

- Nga data 1 Prill 2021, me zbatimin (Go Live) të RrTShB me efekte financiare, OST e filloi aplikimin e komponentes nxitëse, me vlerën zero.
- Objektivi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit është krijimi i një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin si dhe të ofrojnë shërbime balancuese (RrTShB pika 1.1.2.1). “Disbalanca” qoftë pozitive apo negative, duhet konceptuar si penalitet, ndaj çdo pjesëmarrës tregu madje dhe OST, duhet të bëjnë nominime sa më afër faktit, pasi mekanizmi balancues nuk është një mekanizëm përfitues, por disiplinues.
- Nga data 1 Maj 2021, OST ka aplikuar komponentet nxitëse me vlera të ndryshme nga zero duke konsideruar eksperiencën 5 vjeçare të llogaritjes së çmimeve të Disbalancave sipas Koeficientëve të përdorur deri më datë 31.03.2026 në përputhje me “Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”, sipas të cilave, çmimet korrigjoheshin me faktorë nxitës në varësi të nevojave balancuese të sistemit të OST dhe pozicionin e tij balancues kundrejt sistemeve fqinje.

<sup>1</sup> Këtu e në vijim RrTShB

- Nga data 1 Prill 2026, pas eksperiencës 5 vjeçare të aplikimit të komponentes nxitëse si më sipër përmendur, OST ka kryer rishikimin e tyre duke marrë në konsideratë disa elemente objektive, ndër të cilat:
  - Gjendja e sistemit elektroenergjetik;
  - Volumet e energjisë balancuese të siguruara në tregun e brendshëm të balancimit si dhe përmes interkonjeksionit;
  - Analiza historike e bilancit financiar të tregut të balancimit.

OST si më poshtë, përcakton komponentet nxitëse të reja që do të aplikohen prej 1 Prill 2026:

1. Vlerat e Komponentes Nxitëse do të bëhen si më poshtë:

<b>Komponentet Nxitëse</b>
<b><math>K_{nx1} = 0.72 * PE.Bal</math></b>
<b><math>K_{nx2} = 0.05 * PE.Bal</math></b>
<b><math>K_{nx3} = 0.13 * PE.Bal</math></b>
<b><math>K_{nx4} = 0</math></b>
<b><math>K_{nx5} = 0.05 * PMes.Bal</math></b>
<b><math>K_{nx6} = 0.72 * PMes.Bal</math></b>

2. Llogaritja e çmimit të disbalancës bazohet në çmimet e energjisë balancuese të OShB dhe parashikimeve të tjera të RrTShB.

<b>Gjendja e Sistemit</b>	<b>Disbalanca</b>	<b>Llogaritja e Çmimit të Disbalancës:</b>
+1 (Sistemi ka Tepricë)	<i>Pozitive</i>	$PE.Bal - K_{nx1} = PE.Bal - (0.72 * PE.Bal) = 0.28 * PE.Bal$
	<i>Negative</i>	$PE.Bal + K_{nx2} = PE.Bal + (0.05 * PE.Bal) = 1.05 * PE.Bal$
-1 (Sistemi ka Mungesë)	<i>Pozitive</i>	$PE.Bal - K_{nx3} = PE.Bal - (0.13 * PE.Bal) = 0.87 * PE.Bal$
	<i>Negative</i>	$PE.Bal + K_{nx3} = PE.Bal + (0.13 * PE.Bal) = 1.13 * PE.Bal$
0 (Sistemi është në Balancë)	<i>Pozitive</i>	$PE.Bal - K_{nx4} = PE.Bal$
	<i>Negative</i>	$PE.Bal + K_{nx4} = PE.Bal$
2 (Sistemi ka disbalancë të dyanshme)		<b><i>Rasti A</i></b>
	<i>Pozitive</i>	$PE.Bal - K_{nx1} = PE.Bal - (0.72 * PE.Bal) = 0.28 * PE.Bal$
	<i>Negative</i>	$PMes.Bal + K_{nx5} = PMes.Bal + (0.05 * PMes.Bal) = 1.05 * PMes.Bal$
		<b><i>Rasti B</i></b>
	<i>Pozitive</i>	$PMes.Bal - K_{nx6} = PMes.Bal - (0.72 * PMes.Bal) = 0.28 * PMes.Bal$
	<i>Negative</i>	$PE.Bal + K_{nx2} = PE.Bal + (0.05 * PE.Bal) = 1.05 * PE.Bal$

*Sqarime:*

*Rasti A:* Çmimi i Energjisë Balancuese < Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese.

*Rasti B:* Çmimi i Energjisë Balancuese > Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese.

*PE.Bal* – Çmimi i energjisë balancuese.

*Knx* – Komponente nxitëse.

*PMes.Bal* – Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese.

Gjithashtu, rikujtojmë se në mbështetje të RTShB, OST rezervon të drejtën të rishikojë këtë procedurë dhe vlerën e komponentes nxitëse.

